

## Lidhja farefisnore është obligim varësisht nga mundësitë

*Fetaua Ibn Baz [9/414]*

**Pyetje:** Kam motra të martuara dhe nëna ime është e martuar për një burrë tjetër, meqë babai im vdiq. Unë punoj në ushtri dhe dëshiroj që t'i vizitoj ata, por pozita ime nuk ma lejon këtë dhe jam i martuar. Kur shkoj dhe largohem nga familja, më duhet të qëndroj aty së paku tri ditë dhe, gjatë kësaj kohe, nuk do të mund të kujdesem për gruan dhe fëmijët. Pra, a është kjo ndërprerje e lidhjes farefisnore, duke ditur që kam dhe dhjetë muaj që s'kam lidhje me ta?

**Përgjigje:** Lavdi Allahut. Mbjajtja e lidhjes farefisnore është obligim, varësisht nga mundësitë që kanë të afërmit. Në këtë ka dobi të shumta dhe interes të madh. Ndërprerja e lidhjeve farefisnore është nga mëkatet e mëdha, për shkak të thënies së Allahut:

**« Ndoshta, nëse ju japim pushtet, ju bëni çrregullime në tokë dhe i ndërpritni lidhjet farefisnore. Këta i ka mallkuar Allahu, kështu që as nuk dëgjojnë, as nuk shohin »** [Muhamed, 22]

I dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] ka thënë:

**“Nuk do të hyjë në xhenet ai që i ndërpret lidhjet farefisnore”** [Muslim]

Dhe thënia e tij [salallahu alejhi ue selam] ndaj atij që e pyeti:

- O i dërguar i Allahut, kë ta nderoj?
- Nënë tënde, - iu përgjigj.
- Pastaj kë?
- Nënë tënde.
- Pastaj kë?
- Nënë tënde.
- Pastaj kë?, - pyeti për të katërtën herë.
- Babanë tënd, pastaj të afërmit tjerë. [Muslim]

Dhe është transmetuar besnikërisht nga ai [salallahu alejhi ue selam]:

**“Kush do që t'i shtohet furnizimi dhe jetëgjatësia, le t'i mbajë lidhjet farefisnore”**

Hadithet më këtë domethënie janë të shumta. Ty të takon t'i mbash lidhjet farefisnore aq sa ke mundësi, duke i vizituar kurdo që të lehtësohet kjo, nëpërmjet korrespondencës/shkrimit apo nëpërmjet telefonit. Po ashtu, duhet të mbash lidhjet nëpërmjet pasurisë, nëse i afërmi është i varfër. Allahu i lartësuar ka thënë:

« **Kini frikë Allahu aq sa keni mundësi** » [et-Taghebun, 16]

« **Allahu nuk e ngarkon asnjë shpirt përtej mundësive të tij** » [el-Bekare, 286]

Dhe pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë:

“Kur të urdhëroheni për ndonjë gjë, bëjeni atë aq sa keni mundësi”. [*Muteffekun alejhi*]